



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.46/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Dega në Suharekë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së posterave dhe flamujve në shtylla elektrike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Dega në Suharekë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Me datën 22.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV me të cilën pretendon se me datën 22.09.2017 në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, aktivisti i tyre ka vërejtur se nëpër shtylla elektrike ishin vendosur postera të kandidatit për kryetar komune të Suharekës Dr. Sali Asllanaj, si dhe flamujt të subjektit politik, LDK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë të datës 23.09.2017, thekson se vendosja e flamujve përgjatë rrugëve në shtyllat elektrike të cilat janë të përshtatura ekskluzivisht për vendosjen e flamujve në solemnitete të ndryshme por edhe në fushata të këtilla zgjedhore, në asnjë rast nuk mund të përbëjë shkelje të dispozitave të ligjit apo të cilësdo rregull që rregullon këtë segment të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se flamujt e subjektit politik LDK janë të vendosur në shtylla elektrike, janë të qëndrueshme mirëpo paneli ka vlerësuar se vendosja e flamujve lëndor janë të vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e të njëjtëve, ashtu siç vërtetohet nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme përshkrimet në ankesë së është Thyer Kodi i Mirësjelljes nga subjekti politik LDK. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e lartëcekura dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr.46/2017 më datën 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.